



Koronavirusi, shoqëritë dhe ndikimi në ekonominë botërore

Nga Ardian Lekaj

Sot COVID-19 ose koronavirus është shndërruar në kryefjalën e ditës në çdo vend të botës. Dhe nuk është çudi që të gjithë janë të përqëndruar tek kjo temë dhe kanë lënë pas dore tema të tjera që janë deçizive për realitetin ekonomik, shoqëror e politik të Europës dhe të botës, siç është Brexit, situata në Iran/Irak, refugjatët sirianë, konflikti në kufirin Turko-Grek për të përmendur disa.

Brexit i kushton taksapaguesve anglezë rreth 5 miliardë € sipas statistikave të NAO (National Audit Office). Që në tetor të vitit 2019 po punojnë rreth 22 mijë njerëz për këtë çështje, por askush nuk deklaroi shifra transparente dhe të argumentuara për këtë proces të paprecendent dhe ndikimin e tij në ekonominë britanike.

Sigurisht është akoma herët për të thënë se sa do të jetë ndikimi i koronavirusit në ekonominë botërore, por le të marrim vetëm një shembull të dhënë nga IATA (International Air Transport Association) e cila parashikon një humbje 56 deri në 101 miliard euro vetëm për sektorin e fluturimeve. Numri i rezervimeve ka rënë me 50-60 % . Nuk dihet se si do ta përballojnë këtë situatë kompanitë e fluturimeve që kanë kohë që dihet se kanë probleme si "Alitalia" apo "Norwegian Air".

Nga SARS pati një tkurrje në bursat botërore me rreth 40 miliardë \$ por që nga ai moment ekonomia kineze u zhvillua nga vendi i 6 në vendin e dytë sot . Ekonomia kineze në 2003 përfaqësoonte 4.2 % të ekonomisë botërore ndërsa sot 16.3 %.

Nga ana tjetër Kina që është aktualisht vendi më i prekur nga kjo pandemi, është më e fuqishme ekonomikisht sot se sa ishte në vitin 2003.

Të gjitha rregullat e reja që do të vendosin kundra koronavirusit do të shkaktojnë akoma më shumë dëme se virusi vetë. Të gjithë specialistët thonë që ky virus nuk është më i fortë se një grip e prapëseprapë po vihen kufizime të reja. Kjo padiskutim do të ndihet në xhepin e njerëzve. Pas një epidemie të tillë do të rritet papunësia, sëmundjet etj.

Shkrimi i plotë këtu:

<https://www.adbc.al/koronavirusi-shoqerite-dhe-ndikimi-ne-ekonomine-boterore/>

DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



Kryesia e Dhomës së Biznesit të Diasporës zhvilloi mbledhjen e parë për vitin 2020

Kryetari i Kryesisë z. Ardian Lekaj informoi anëtarët lidhur me çështjet e rendit të ditës, me fokus kryesor diskutimin dhe miratimin e rregullores së Dhomës së Biznesit të Diasporës Anëtarët e Kryesisë gjithashtu u informuan mbi aktivitetin e Dhomës së Biznesit të Diasporës, bashkëpunimet e deritanishëm midis Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare, Agjencisë Shqiptare për Zhvillimin

e Investimeve (AIDA) dhe Agjencisë së ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

Gjithashtu u diskutua edhe për organizimin e Forumit të Biznesit të Diasporës Shqiptare, i cili paraprakisht është vendosur të zhvillohet në 3-4 qershor 2020.

Gjatë mbledhjes gjithashtu anëtarët e Kryesisë analizuan dhe prezantuan disa ide konkrete rreth strategjisë për zhvillimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare si dhe shërbimeve që ajo do të ofrojë në të ardhmen.

Në përfundim të mbledhjes, u miratua në unanimitet Rregullorja e Dhomës së Biznesit të Diasporës si dhe disa akte të tjera administrative.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin Presidenti i Nderit i Dhomës së Biznesit të Diasporës Z. Lazim Destani dhe anëtarët e tjerë të kryesisë Kledis Panajot Rumi (Greqi), Bujar Zhuri (Norvegji), Visar Tasimi (SHBA), Jorida Qirjako (Britani e Madhe si dhe Ergys Luga (Itali).

<https://www.adbc.al/kryesia-e-dhomes-se-biznesit-te-diaspores-zhvilloi-mbledhjen-e-pare-per-vitin-2020>



Dhoma e Biznesit të Diasporës organizoi mbledhjen e parë të Asamblesë së Përgjithshme

Mbledhja e Asamblesë së Anëtarëve është një prej aktiviteteve më të rëndësishme të Dhomës së Biznesit, e cila shërben për të bërë një bilanc të punës së zhvilluar që prej krijimit të Dhomës. Kryetari i Dhomës së Biznesit të Diasporës z.Ardian Lekaj komunikoi se kuota e anëtarësimeve pranë Dhomës do të jenë 0 (zero) deri në muajin Nëntor 2021, si rezultat i mbështetjes dhe asistencës financiare nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës nëpërmjet projektit "Për Dhomën e Biznesit të Diasporës" - krijimi dhe investimeve në Shqipëri

Nismë kjo e cila u mbështet nga Presidenti i Nderit i Dhomës së Biznesit të Diasporës z. Lazim Destani dhe anëtarët e tjerë të asamblesë të pranishëm në mbledhje Kledis Panajot Rumi, Bujar Zhuri, Silva Mecaj dhe Gjin Gjoni.



FMN: Fonde për shëndetësinë/ Deklarata nga Uashingtoni për Shqipërinë

[> Link <](#)



Bankat ngrijnë kështet e kredisë për 3 muaj, mbyllën sportelet e UKT dhe OSHEE

[> Link <](#)

Java në lajme



Dhoma Amerikane e Tregtisë: Qeveria në Shqipëri të planifikojë një stimul ekonomik

[> Link <](#)



Pezullimi i programeve të agjencisë amerikane, mesazh i keq për Kosovën

[> Link <](#)

Dy vendime qeverie



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I MINISTRAVE

Bazuar në situatën emergjente të krijuar në gjithë botën për shkak të pandemisë së Koronavirusit Këshilli i Ministrave ka miratuar disa vendime për parandalimin e virusit në Shqipëri. Në mbledhjen e radhës është miratuar vendimi për "Marrjen e masave për ngritjen e infrastrukturës për shërbimin e karantinës" dhe për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes. Gjithashtu është miratuar vendimi për "Një shtesë fondi në buxhetin e vitin 2020, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për infeksionin e shkaktuar nga Covid-19".


Sipas vendimit Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në programin "Planifikim, Menaxhim dhe Administrim", i shtohet fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për infeksionin e shkaktuar nga COVID-19 .

Gjithashtu në kuadër të situatës emergjente janë marrë edhe disa vendime të rëndësishme për ndalimin e qarkullimit të njerëzve dhe automjeteve në disa prej qyteteve të vendit.

Më shumë mund të lexoni këtu:

<https://kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-09-mars-2020>

Kursi zyrtar i këmbimit



Dollar Amerikan	USD	109.26	+0.64
Euro	EUR	122.79	-0.02
Poundi Britanik	GBP	139.22	-1.27
Franga Zvicereane	CHF	116.33	+0.27
Jeni Japonez (100)	JPY	105.26	+1.86
Dollari Australian	AUD	70.11	-0.76
Dollari Kanadez	CAD	79.23	-0.15

Rreth Dhomës së Biznesit për Diasporën Shqiptare

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare është organizata e parë në shërbim të bizneseve të Diasporës. Si një organizatë e pavarur jo-fitimprurëse, ne jemi të përkushtuar të ndihmojmë dhe të nxisim bizneset e të gjitha madhësive për të maksimizuar potencialin e tyre në Shqipëri. Dhoma e Biznesit të Diasporës është një mundësi reale për mbështetjen e investitorëve të Diasporës që dëshirojnë të krijojnë apo të zgjerojnë biznese të tyre në atdhe.



Numrin e radhës të revistës Monitor mund ta lexoni këtu : www.monitor.al



Gazetën Çelësi mund ta lexoni këtu: <http://www.yellowpagesalbania.com>

